

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

Blegtoria

ID 7.8/a “Rritje intensive e shpendëve në një instalim”

(sipas shtojcës 1 të Ligjit 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448, datë 14.07.2011, të ndryshuar”)

SUBJEKTI: ARNA - SHPK

NIPT: K14128001J

VENDNDODHJA: Korce, Drenove, Rruga Korçe-Boboshtice, Zona Kadastrale nr.1228, nr.pasurie 126/5.

1. PROFILI I KOMPANISE

Subjekti ARNA - SHPK eshte regjistruar ne QKB me date 28/05/2001, me forme ligjore si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuara, me NIPT K14128001J dhe administrator Jani Kapurani.

Subjekti do te aplikojë për leje mjedisi Tip B

Klasifikimi bazuar ne ligjin 10448 datë 14.07.2011, të ndryshuar:

Blegtoria;

ID 7.8/a “Rritje intensive e shpendëve në një instalim”

Referuar shtojces 1 te ligjit 52/2020 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR.

2. OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT:

- ❖ Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:
 - Emetimet ne ajer dhe zhurmat;
 - Ndikimi ne flore/faune;
 - Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti i punetoreve;
 - Ndikime social-ekonomike;
 - Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara;
 - Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor;
 - Ndikim ne peizazhin e zones;

- ❖ Objektivi i dyte i ketij aktiviteti eshte gjetja e alternativave qe jane me miqesore me mjedisin.

3. VENDNDODHJA E AKTIVITETIT

Vendndodhja e aktivitetit eshte: **Korce, Drenove, Rruga Korçe-Boboshtice, Zona Kadastrale nr.1228, nr.pasurie 126/5.**

Objekti identifikohet sipas ortofotos se meposhteme:



Koordinatat sipas Gauss Kruger

Nr.	X	Y
1.	4479840.81	4492284.95

4. PERSHKRIMI AKTIVITETIT

ID 7.8/a “Rritje intensive e shpendëve në një instalim”

Kapaciteti I projektuar është 29000 krere.

Proceset qe zhvillohen:

Silloset e ushqimit

Pjese shume e rendesishme e impiantit është sillosi I ushqimit. Brenda ti garantohet mbajtja e ushqimit ne kushte konstante te temperatures, lageshtise etj.

Linja e shperndarjes se ushqimit

Shperndarja e ushqimit neper kafaze realizohet ne menyre automatike. Kanalet e ushqimit jane te lidhur me karrelat levizese, me ndihmen e te cilave realizohet shperndarja e ushqimit per cdo kafaz.

Linja e furnizimit me uje

Shperndarja e ujit neper kafaze realizohet ne menyre automatike. Brenda secilit kapanon është vendosur depozita e ujit, nga ku behet shperndarja me ndihmen e sistemit me rubineta.

Grumbullimi I manureve

Mbetjet e shpendeve mbildhen ne menyre automatike nepermjet transportiereve te instaluar poshte cdo kati me kafaze. Me ndihmen e ketij sistemi, manuret transportohen ne vaskat e mbledhjes se tyre, te vendosura ne fund tec do baterie. Qe ketej, nepermjet nje kanali me zinxhire ne forme transportieri nxirren jashte kapanonit per ne gropen e posacme.

Sistemi I kontrollit te parametrave te ajrit

Ndricimi dhe kontrolli I parametrave te ajrit Brenda kapanoneve realizohet ne menyre automatike, nepermjet sensoreve.

Paneli I kontrollit

I gjithë cikli brenda kapanoneve zhvillohet ne menyre automatike dhe kontrollohet nepermjet panelit te kontrollit. Ne secilen bateri jane instaluar sensore ndjeshmerie qe marrin dhe dergojne sinjale ne panelin e kontrollit.

5. IDENTIFIKIMI DHE VLERESIMIT I SHKARKIMEVE NE MJEDIS

SHKARKIME NE AJER

Emetime ne ajer nga ky instalim mund te cilesojme aroren e shpendeve, gjithashtu dhe shkarkime nga mjetet e transportit qe perdoren nga aktiviteti. Por keto shkarkime jane ne vlera te paperfillshme.

SHKARKIME NE UJERA

Nuk ka shkarkime te ujerave teknologjik ne mjedisin perreth. Mund te permendim vetem ujerat higjieno-sanitare, te ambjenteve te tualeteve dhe larjes e pastrimit te ambjenteve te punes. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

SHKARKIME NE TOKE

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjenteve te pershtatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe kapanone te mbuluara.

ZHURMA DHE VIBRIME

Zhurmat ne abjentet e instalimit gjenerohen gjate proceseve teknologjike te rritjes se shpendeve (pulave) dhe nga mjetet e transportit per kohen kur ato jane ne pune. Keto zhurma jane brenda normave te lejuara dhe duke qene nje aktivitet qe zhvillohet ;larg zones se banuar, nuk perbejne aspak problem.

MBETJE

Mbetjet nga aktiviteti: Jashtëqitjet, te cilat perdoren per pleherimin e tokave. Perdorimi I plehut te pulave nga kompania perben nje hallke fundore shume te rendesishme per mbrojtjen e mjedisit.

Mbetjet e ngurta qe dalin si rezultat I aktivitetit te punonjesve do te grumbullohen ne vendet e caktuara nga shoqeria dhe me pas do te dergohen per ne vendet e caktuara nga pushteti vendor. Do te punohet qe keto mbetje te ndahen qe ne burim dhe do te perdoren konteniere hermetike qe te evidentohen aromat e pakendeshme qe mund te vijne si pasoje e kushteve klimatike.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona ne te cilen ushtrohet aktiviteti eshte nje zone ne te cilen nuk takohen elemente te spikatur te flores. Perreth kesaj zone mund te hasim bimesi te ulet dhe barishte. Aspekti faunistik paraqet nje larmi biologjike te varfer. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk paraqet asnje ndikim negative ne flore apo faune.

NDIKIM SOCIAL-EKONOMIK

Me operimin e ketij aktiviteti pritjet te kete nje impakt pozitiv ne ekonomine e vendit. Operatori do te punesoje personel te zones, duke bere te mundur rritjen e nivelit ekonomik dhe te punesimit.

SUBJEKTI: ARNA- SHPK

Administrator

Jani Kapurani